

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, , bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić anëtar, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtorit Profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

**R. Dj., nga Podgorica, Republika Crna Gora**

Kundër;

**Pala përgjegjëse 1: A. B., Gjakovë ( e përfaqesuar nga Avokat O. C. nga Peja**

**Pala përgjegjëse 2: D.B., nga Komuna Gjakovë**

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës( më tej KKPK) KPCC/D/A/260/2014, lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) me numër KPA..., të datës 21 Tetor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 24 Prill 2019, merr;

### **AKTGJYKIM**

- 1. Ankesa e paraqitur nga R. Dj., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA..., refuzohet si e pabazuar**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numër, KPA...**

### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;**

1. Me datë 27 Nëntor 2006, R. Dj. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP), në cilësinë e bartësit të drejtës pronësore, si bashkëpronare me 1/3 pjesë ideale ,me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore, dhe ri-posedimin e ngastrave kadastrale, nr. ..., ..., ... dhe nr. ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.34.26 h, me kulturë tokë bujqësore, të cilat ndodhen në vendin e quajtur “Lugbunar”, Komuna kadastrale ..., Komuna Gjakovë, (në tekstin e mëtejme; prona e kërkuar)

2. Paraqitësja e kërkesës,( tani palë ankuese), pohon se e ka humbur mundësin e posedimit dhe shfrytëzimit të pronave të kërkuara si pasojë e konfliktit të viteve 1998/99, si datë të humbjes e shënon datën 11.06.1999. Po ashtu sqaron se pronat e kërkuara janë të uzurpuara dhe duke u shfrytëzuar nga Kooperativa Bujqësore në ..., dhe D. B..
3. Së bashku me kërkesën ajo kishte dorëzuar në AKP *inter alia* dokumentet vijuese;
  - Kopjen e planit kadastral, të dt. 05.12.1994, që paraqet vend ndodhjen e ngastrat kadastrale ..., ..., ... dhe nr....
  - Certifikatën nga Libri Amë i të vdekurve, të dt. 21.01.1976, që e dëshmon vdekjen e babait të saj R. (M.) B..
  - Vendimin e Trashëgimisë nr. 20/76, dt.17.01.1995, lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjakovë sipas të cilit pas vdekjes së babait të palës ankuese R. B., (i cili e kishte të drejtën e pronësisë me ¼ pjesë ideale të pronave në Fletën Poseduese nr..., Zona kadastrale ..., dhe Fleta Poseduese nr..., Zona kadastrale ...), është trashëguar nga pala ankuese R. me 1/3, pjesë ideale, dhe nëna e saj D. B. me 2/3, pjesë ideale, ndërsa motra e saj J., kishte hequr dorë nga trashëgimia në favor të nënës së saj.
  - Aktgjykimin, Y. nr.2351/98,dt.25.11.1998, lëshuar nga Gjykata Supreme e Serbisë me të cilin anulohet Vendimi i Entit Republikan të Gjeodezisë në Beograd, nr. ..., i dt. 21.04.1998, dhe lënda i kthehet këtij organi në rivendosje.
  - Certifikatën nr. ..., të dt. 18.03.2002, lëshuar sipas kërkesës së palës ankuese nga Enti Republikan i Gjeodezisë në Beograd, me qëllim të mbrojtjes së drejtave pronësore, me të cilin dëshmohet se në këtë organ, përkatësisht shërbimin për kadastër të paluajtshmërive në Gjakovë, është në rrjedhë procedura e vërtetimit të lëshimeve dhe mangësive në Operatin kadastral për Komunën Kadastrale B... dhe Komunën Kadstrale ..., gjithnjë sipas Aktvendimit të Entit Republikan për Gjeodezi, 03 nr. ..., të dt.09.02.2000, i nxjerrë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Y.br.2351/98, dt.25.11.1998. Procedura i përfshinë ndër ngastrat e tjera edhe ngastrat kadastrale, nr. ..., ..., dhe ..., Komuna Kadastrale ...
  - Vendimet e Komisionit të Kërkesave Ppronësore e Banësore HPCC/D/176/2005/C dhe HPCC/D/176/2005/C për ngastra tjera që nuk janë objekt shqyrtimi në Vendimin e KPCC-së e as të ankesës.
4. Njoftimi i kërkesës për këtë pronë, nga AKP-ja ishte bërë me datë 26 Nëntor 2010., sipas raportit të notifikimit prona e kërkuar, përkatësisht ngastrat kadastrale nr. ... ishte blerë nga Dedë Bala, dhe gjatë kohës së vizitës është gjetur pronë komerciale me ndërtime. Në ngastrën kadastrale ..., është gjetur A. B., dhe ka refuzuar të nënshkruaj njoftimin për pjesmarrje. Ngastra ... ishte gjetur tokë e pakultivuar kurse ngastra ... ishte gjetur rrugë publike.

5. Me datë 6 Mars 2009 A. B., është paraqitur në AKP dhe ka pjeset e pronëe se kekruar gjegjesishte ngastrat ... dhe ..., gjenden në tabelën e komasacionit dhe rirregullimit të tëkës numer 330 dhe se ai është pronar i tyre nbi bazën e kontrates se shitblerjlës dhe vendimit të autoritetit të komasacionit. Për të mbeshtetur pretendimin ai paraqiti:
  - Aktvendimin e Komasionit të datës dhe kontrata e shitblerjës për ngastrat ...,... dhe ... dhe se deshmoet se i janë nënshtruar komasionit.
6. Sipas raporteve të Verifikimit të sekretarisë së AKP-së pronat e kërkuara nga pala ankuese si dhe dokumentet e verifikuar nga ky organ tregojnë se dikur këto prona kanë qenë të regjistruara në emër të palëve të treta, dhe të kushërinjve të palës ankuese. Sipas Drejtorisë së kadastrit të Komunës Gjakovë nuk ka qenë e mundur të ofrohet një historiat dhe të dhëna se kur janë bartur pronat e kërkuara tek palët e treta për shkak të zhvendosjes së dokumenteve kadastrale në Serbi.
7. Nga dokumentet e paraqitura nga palët përgjegjëse, po ashtu dëshmoet se në Komunën Kadstrale ..., ka pasur Komasion të pronave, i cili ka zgjat prej vitit 1983, deri në vitin 2004, kur është përfunduar.
8. Sipas Raportit të konsoliduar të verifikimit nga AKP, të datës 30.09.2014, të dokumenteve të palëve dhe sigurimit *ex officio* të Fletave Poseduese (CDP), me 10.08.2007, 12.05.2011, dhe 26.06.2014, për pronën e kërkuara, ngastrat kadastrale ..., ..., ..., dhe nr.....R, N. dhe B.si dhe ¼ në emër të Kombinatit Bujqesor "...". Aktgjykimi nr. ... i dt. 25.11.1998 i Gjykatës Supreme të Serbisë dhe Vendimi i Trashëgimisë, OV.nr.... i dt. 17.01.1995, i Gjykatës Komunale të paraqitura nga pala ankuese janë verifikuar pozitivisht.Po ashtu kishte deklaruar se në vitin 1993 pas shitjes së rreth 0.88.00 ha familjes së Dedë Bala ,familja e saj kishte kuptuar se së paku edhe tre hektarë tokë të tyre nuk ishin regjistruar në kadastrë në emër të tyre, për këtë i ishte drejtuar shërbimit Kadastral në Gjakovë, mandej në Prishtinë dhe me ankesa i është drejtuar edhe Gjykatës Supreme të Serbisë dhe kjo çështje është ende kontestuese dhe e pa zgjidhur.
9. Me datë 21 Tetor 2014, KKPK-ja, me Vendimin numër, KPCC/D/A/260/2014, e hedhë poshtë kërkesën e palës ankuese, KPA17588, që i përfshinë ngastrat ..., sipas arsyeve konkrete në paragrafin 18, për veç arsyeve në paragrafët e tjerë në vendimin grupor për shkak se, kërkesa e palës ankuese bie jashtë juridiksionit të Komisionit, pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Tutje ndër të tjera sqarohet se komisioni konstaton se në bazë të llojeve të ndryshme të dokumenteve dhe të siguruar *ex officio* apo në bazë të vet deklaratave të palëve dëshmoet se ka dështuar të tregoj se kërkesa e saj i përfshinë rrethanat që lidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konflikti i viteve 1998/99. Nga këto rrethana komisioni vlerëson se kërkesa e paraqitëses nuk i ka përmbushë kushtet për tu shqyrtuar sipas nenit 3.1 paragraf 3, të Rregullores së UNMIK-ut,2006/50, e ndryshuar me

Ligjin nr.03/L-079, dhe rrjedhimisht kërkesa është jashtë juridiksionit të komisionit andaj si e tillë hedhet poshtë.

10. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese R. Dj. me datë 06.02.2015, ndërsa palës përgjegjëse A. B. me 9 Shkurt 2015 dhe palës përgjegjëse D. B. me datë 10.02.2015.
11. Me datë 20.02.2015, pala ankuese R. Dj.ç, ka parashtruar ankesë. Ankesa i është dorëzuar, palës përgjegjëse D. B. me datë 18.02.2016 dhe nuk ka paraqitur përgjigje në afatin ligjor.
12. Ankesa i është dorëzuar, palës përgjegjëse A. B., me 1 Shkurt 2016 palës përgjegjëse A. B. përmes te autorizuarit O. C., avokat nga paraqitur përgjigje në ankese me 26 Shkurt 2016.

### **Pretendimet e palës ankuese**

13. Pala ankuese e kundërshton në tërësi Vendimin e KKPK-së, për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave procedurale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike .
14. Sipas palës ankese nuk kuptohet se sipas cilave konkludime i janë hedhur shtatë kërkesat e saj nga AKP-ja, tutje në ankesë e përshkruan historikun e gjendjes së pronave të saj dhe humbjen e tyre, ashtu si edhe në kërkesë dhe përgjigjeve plotësuese me shkrim dhe komunikimeve që i ka dhënë në AKP, në ankesë nuk jep sqarime konkrete lidhur me pronat, por thekson në mënyrë të përgjithësuar ndër të tjera se; pronat e kërkuara janë të saj dhe nënës së saj të trashëguara nga babai i saj, se e tyre është prona në sipërfaqe të përgjithshme prej 9.77.60 ha, në Zonën Kadstrale ... dhe 2.64.40 ha, në Zonën Kadstrale Gjakovë, se kadastrri në mënyrë jo ligjore ua ka zvogëluar pronën për 7.13.29 ha, dhe se ekziston papërputhshmeria e gjendjes në terren dhe evidencës kadastrale dhe në disa raste janë vërejtur lëshimet në kadastrë, se nuk i është dhënë asnjë gjendja nga kadastrri në Gjakovë dhe as nga AKP, andaj konsideron se ende ka lëshime edhe pse për këtë ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme, ( i citon dokumentet të cilat edhe më parë i ka paraqitur në AKP të viteve 90 -ta dhe pas vitit 2000 të lëshuara nga Gjykata Supreme e Serbisë dhe Enti Republikan i Gjeodezisë, në Beograd). Tutje i përshkruan vendimet KKPC ( HPD-së), që sipas saj asnjëherë nuk janë ekzekutuar për t'iu kthyer posedimi. Po ashtu thekson se kërkesat e saj janë vendosur në mënyrë diskriminuese sepse kjo është përzënë nga pasuria e saj për shkak të rrethanave të luftës dhe nëna e saj është vrarë, andaj vlerëson se vendimi i KKPK-së, është jo i drejtë, pa bazë ligjore, i pa kuptueshëm, dhe jo i arsyetuar.

### **Pretendimet e palës përgjegjëse A. B.**

15. Pala përgjegjëse përmes të autorizuarit ka deklaruar se pronen që e shfytëzon e ka blerë me kontratë të vertetuar ne gjykatë dhe me vendim të organit komunal të komasacionit. Ai konsideron se Vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe i ligjeshëm prandaj i propozon Gjykatës që të nxjerr aktgjykim me të cilin të ta refuzonte ankesën si të pa bazaur.

Arsyetimi ligjor

16. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës pretendimeve ankimore dhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të Ligjit Nr.03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, gjykata gjenë se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme sipas nenit 186 par.1, lidhur me nenin 196 të LPK-së.
17. Gjkata Supreme, pasi shqyrtoi pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjes së lëndës, konstaton se Vendimi KKPK-së nuk është i përfshirë me asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj ankesa nuk mund të miratohet.
18. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja, ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore, “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, apo që rezultojnë nga ai. Prandaj paraqitësi i kërkesës duhet të paraqes jo vetëm titullin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe të dëshmoj se ai apo ajo nuk është në gjendje ti ushtroj këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërliken drejtpërdrejtë me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
19. Nga provat në shkresa të lëndës të administruara nga KKPK-aj, pa dyshim vërtetohet se prona e kërkuara nuk ishte humbur si pasojë e konfliktit të viteve 1998-99, ashtu si pretendon pala ankuese. E njëjta për veç se e paraqet një Vendim plotësues të trashëgimisë ,pas Vendimit fillestar të lëshuar në vitin 1995, sipas të cilit ajo dhe nëna e saj paraqiten si bashkëpronare të pronave të tjera dhe pronave të kërkuara i cili dokument është verifikuar pozitivisht, megjithatë këto dokumente nuk e pasqyrojnë gjendjen reale të fakteve të gjetura *ex officio*, nga Sekretaria e AKP-së, sepse pronat e kërkuara- ngastrat kadastrale ..., ..., ... dhe nr...., është gjetur se evidentohet në emër të në emër të families B., me nga ¼ në emer të R., N. dhe B. si dhe ¼ në emër të Kombinatit Bujqësor “...”ose edhe ne në emër të palëve të treta si u përshkrua në paragrafin të këtij aktgjykimi dhe tek raporti i konsoliduar i verifikimit të AKP-së del se nuk ishte shkak i humbjes konflikti apo rrethanat që lidhen me të.
20. Nga gjendja e cekur si më lartë nga sqarimet e vet palës ankuese në AKP, dhe tani në ankesë si dhe Shkresave të lëshuara nga Enti Republikan i Gjeodezisë të Serbisë, të vitit 1994 dhe 2002 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë, Y.nr.2351/98,dt.25.11.1998, (këto prova i bashkëngjit edhe në ankesë), pa dyshim vërtetohet se paqartësitë dhe kontesti lidhur me pronat e kërkuara dhe pronat e tjera sipas kërkesave të tjera në AKP, lidhur me të drejtën pronësore të palës ankuese janë të karakterit familjar që kanë ekzistuar shumë vite më parë para periudhës së konfliktit të viteve 1998/99, dhe për këtë i është drejtuar edhe organeve administrative të kadastrit, dhe me padri organeve gjyqësore prej vitit 1993 e tutje, për të dëshmuar të drejtën e saj pronësore, edhe nga këto fakte dëshmohet se humbja e

posedimit të pronave të cilat janë kontestuese qysh më herët nuk janë humbur si pasojë konfliktit të viteve 1998/99.

21. Pala ankuese kishte konfirmuar për mes deklaratave të shkruara dhe bisedave me Sekretarin e AKP-se, se familja e saj kishte pasur një kontest pronësor para konfliktit me personat të cilët kishin arritur ti regjistronin këto prona në emër të tyre në shënime Kadstrale.
22. Nga faktet e theksuara nga vet pala ankuese si më lartë shënimeve kadastrale të ekzaminuara *ex officio*, dhe deklaratave të dhëna nga palët e treta të cilët po ashtu ia kontestojnë si jo të drejtë dhe ligjore kërkesën e saj, në tërësi provohet se këto prona të cilat i kërkon pala ankuese, nuk janë humbur si pasojë e rrethanave të konfliktit të viteve 1998/99, sepse sipas palës ankuese kontesti është prej viteve të 70-ta, edhe me palët e treta, ndërsa në kadastër prona nuk është në emër të saj por në emër të palës së treta, gjegjësisht sipas shënimeve kadastrale të vitit 1994 ngstra kadastrale ngastrat kadastrale ..., ..., ... dhe nr...., është gjetur se evidentohet në emër të në emër të familes B. me nga 1/4 në emer të R., N. dhe B. si dhe 1/4 në emër të Kombinatit Bujqesor "...".
23. Dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk e paraqesin gjendjen dhe nuk i pasqyrojnë ndryshimet të cilat ishin bërë në kadastër pas viteve 1956 dhe 1976, dhe nuk i pasqyrojnë të dhënat aktuale kadastrale të pronave të kërkuara. Ky fakt provohet edhe në bazë të dokumentave të paraqitura nga pala ankuese dhe nga gjetjet *ex officio* të Sekretarisë së KPA-së.
24. Gjykata Supreme, sipas konkludimeve të cekura si më lartë, theksimeve në ankesë dhe provave në shkresa të lëndës vlerëson se pala ankuese nuk ka dëshmuar se humbja e posedimit të pronaës së kërkuara ka të bëjë me konfliktin. Andaj padyshim vërtetohet se KKKPK, si në vendimin e saj, me të drejtë dhe bazë ligjore ka marrë vendim të drejtë kur ka gjetur se kërkesa e palës ankuese nuk është në përputhje me nenin 3.1, parag 3., të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, për tu shqyrtuar dhe vendosur, andaj në mungesë juridiksioni nga AKP-ja për të vendosur mbi meritat e kërkesës është hedhë poshtë.
25. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese, apo palës së interesuar lidhur me të drejtën pronësore dhe as nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës, ushtrimin e një kërkesë para organit apo gjykatës kompetente, nëse vlerësohet me interes legjitim.
26. Nga të lartë cekurat e në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore;**

Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINE**

**GSK-KPA-A-011-2016 me datën 24 Prill 2019**

**Bashkp. Profesional**

**Sherif Krasniqi**

**KRYETARI I KOLEGJIT**

**Beshir Islami**